

VENDIM
Nr. 112, datë 13.2.2020

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË AGJENCISË
SHTETËRORE TË KADASTRËS, TË TRUALLIT ME SIPËRFAQE 620 m² DHE TË
NDËRTESES DYKATËSHE, ME SIPËRFAQE 116 m², PJESË TË PASURISË 1/156,
ZONA KADASTRALE 1664, NJËSIA ADMINISTRATIVE FUSHË-KRUJË, BASHKIA
KRUJË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 13, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës të truallit me sipërfaqe 620 (gjashtëqind e njëzet) m² dhe të ndërtesës dykatëshe, me sipërfaqe 116 (njëqind e gjashtëmbëdhjetë) m², pjesë të pasurisë 1/156, zona kadastrale 1664, Njësia Administrative Fushë-Krujë, Bashkia Krujë, sipas hartës kadastrale bashkëlidhur këtij vendimi, për ushtrimin e funksioneve administrative të Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Krujë.

2. Agjencisë Shtetërore të Kadastrës i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përdorimit të pasurisë së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

3. Ngarkohet Agjencia Shtetërore e Kadastrës për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama


HARTE KADASTRALE (Fragment)

AGJENCIA SHTETËRORE
E KADASTRËS

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

ARTAN LAME

Njësia e Kadastrës dhe Hartografisë
Drejt. And PROKO



A. IDENTIFIKIMI I PASURISË

ZONA KADASTRALE: 1664 NR.LPASURISË: 1/156 Vol __ Fq __
INDEKSI I HARTËS: KR-D-3 SHKALLA: 1:500

E-3

ADRESA E PASURISË: FUSHË KRUJË Q/F FUSHË KRUJË

Rr/L. P/G SH K AP

B. KUFIZIMET

C. PRONARI

VERI: 1/507

SHTET

JUG: 1/517


LINDJE: 1/156

PERENDIM: 1/308

D.Data: 30.10.2019

Ora:

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE KRGJSH



LEGJENDË

Pika	X	Y	Pika	X	Y
1	476875,6 m	4593899,2 m	11	476855,8 m	4593863,4 m
2	476877,9 m	4593898,2 m	12	476857,9 m	4593874,2 m
3	476876,6 m	4593895,3 m	13	476867,8 m	4593892,0 m
4	476868,3 m	4593881,2 m	14	476859,2 m	4593873,3 m
5	476875,7 m	4593877,7 m	15	476865,2 m	4593871,9 m
6	476874,8 m	4593875,6 m	16	476864,6 m	4593869,4 m
7	476894,1 m	4593865,3 m	17	476874,0 m	4593867,2 m
8	476889,1 m	4593864,3 m	18	476872,6 m	4593861,0 m
9	476889,5 m	4593862,8 m	19	476857,2 m	4593864,6 m
10	476864,1 m	4593858,5 m			

Shënim: Sipërfaqja e konturuar me të kuqe është pasuria objekt i Projekt Vendimit.